

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Njohja / *el-Ma'rifeh* / المَعْرِفَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Seksioni i Përfundimeve

Për sa i përket seksionit të përfundimeve, kjo ka dhjetë shkallë: njohja, asgjësimi, qëndrimi, konfirmimi, ngatërrimi, realiteti, zhveshja, veçimi, bashkimi, njësimi

Allahu ﷻ tha:

"وَإِذَا سَمِعُوا مَا أُنزِلَ إِلَى الرَّسُولِ تَرَى أَعْيُنُهُمْ تَفِيضُ مِنَ الدَّمْعِ مِمَّا عَرَفُوا مِنَ الْحَقِّ"

“Kur ata dëgjojnë çfarë i është shpallur të Dërguarit, sheh sytë e tyre të përloten, për shkak të asaj që njohin nga e vërteta.”¹ (el-Ma’ideh, 83)

Njohja është përfshirja e qenësisë² së gjërave. Kjo ka tri nivele dhe njerëzit lidhur me to ndahen në tri grupe.

Niveli i parë është njohja e attributeve (hyjnore). Emrat e attributeve kanë ardhur në Shpallje dhe shenjat treguese të tyre janë të qarta në krijim. Kjo njohje arrihet me: të parit e dritës shpirtërore, me mirëqenien e mendjes nëpërmjet reflektimit, dhe me gjallërinë e zemrës nëpërmjet hetimit të duhur,

¹ *El-Ma'rifeh* mund të përkthehet si “gnostikë / dije e së vërtetës shpirtërore”, por, për shkak të konotacionit negativ që ka ky term, preferoj të përdoret origjinali në arabisht, domethënë “njohje”. Në terminologjinë e Mjeshtërvë të Shtegut të pastrimi shpirtëror, kjo nënkupton dijen e zemrës që është e pastër, e dobishme, dhe reformuese. Ky ajet u përzgjedh nga shejhu, sepse njohja “*ma'rifeh* / njohja” e tyre ua përloti sytë, pra kjo vërtet ishte një njohje, jo vetëm dije. Përdorimi që Kurani i bën *ma'rifeh* / njohjes dhe *ilm* / dijes është zakonisht pozitiv, por të dy këta terma janë përdorur edhe për të treguar dijen e pafrytshme.

² Ky përkufizim e bën të pamundur njohjen e Zotit, sepse askush s’mund ta përfshijë qenësinë e Tij as me dije, as në ndonjë formë tjetër. Mirëpo, qëllimi i shejhut këtu është që, me një realitet mendor të shtuar, të theksojë plotninë dhe përsosurinë e kësaj dijeje dhe qëndrueshmërinë e saj.

të mbështetur nga madhërimi dhe përsiatja³. Kjo është njohja që arrijnë masa e gjerë e njerëzve, pa të cilën nuk u përmbushen kushtet e bindjes. Dhe kjo më tej ka tri shtylla:

- Konfirmimi i atributiveve me emrat e tyre (të shpallur) pa i asimiluar⁴.
- Refuzimi i asimilimit të atributiveve pa i mohuar⁵
- Dëshpërimi nga të kuptuarit e thelbit të atributiveve dhe njohjes së realitetit të tyre ontologjik⁶

Niveli i dytë është njohja e qenësisë (*dhaat*) duke lënë dallimin mes atributiveve dhe qenësisë⁷. Kjo vendoset me anë të dijes së bashkimit⁸, bëhet e qartë në

³ Këta njerëz do të njohin atributet hyjnore që përmenden në Shpallje dhe që vërtetohet nga shenjat në krijim nëpërmjet mprehtësisë së tyre shpirtërore, mendjeve reflektuese, dhe zemrave të buta që janë reflektuese dhe plot përnderim për Të.

⁴ Konfirmimi i atributiveve hyjnore pa asimilim (pa i ngjasuar me ato të krijesave) dhe pa mohim (*ithbaat bi-la temthil we tenzih bi-la te'til*).

⁵ Pasi të përgatitim të kuptuarit e tonë me pakrahasim (*tenzih*), ne lëmë fuqinë dhe pasurinë e Shpalljes të rrjedhin në zemrat tona të papenguara nga vërejtjet intelektuale.

⁶ *Te'wili* ka tri kuptime:

1. Realiteti ontologjik (qenësor) i një çështjeje dhe mu thelbi ose fundi i saj
2. Tefsiri (shpjegimi) i kuptimit të tij. Shumë nga komentuesit e hershëm të Kuranit tefsirin e quanin *te'wil*
3. Shmangia nga kuptimi primar (*dhahir*) në favor të kuptimit sekondar (*mexhazij*).

Kur kemi të bëjmë me atributet hyjnore, kuptimi i parë i përket vetëm Allahut. Kuptimi i dytë u përket të gjithë njerëzve që flasin gjuhën e Shpalljes lidhur me thëniet e qarta dhe dijetarëve që flasin me dije të rrënjësuar lidhur me thëniet e ndërlikuara (në Shpallje). Kuptimi i tretë është i diskutueshëm. Përgjithësisht pranohet se Paraardhësit e devotshëm nuk lëshoheshin në këtë. Ata konfirmonin kuptimet primare pa i asimiluar a pa përcaktuar një mënyrë për to.

⁷ Duke komentuar një thënie të ngjashme, Imam Ibn el-Kajjim tha në *el-Medarixh*: “Qëllimi i shejhut (el-Harawi) dhe i të ngjashmëve më të nga njerëzit e drejtë është që zemra të mos konsumohet në të parit e vetëm një nga atributet, por të jetë i vëmendshëm për qenësinë (*dhaat*) që përshkruhet nga të gjitha atributet e përsosurisë dhe të madhësisë. Vetëm atëherë të parët do të dëshmojnë qenësinë (*dhaat*) se bashku me atributet. S'ka dyshim se kjo shkallë është më e lartë sesa të parët e vetëm një atributi.”

⁸ Dija për bashkimin është e ndryshme nga thelbi i tij, që do të përmendet më vonë, që është përjetimi i realitetit të bashkimit. Ky është bashkim dëshirash, jo bashkim ontologjik (qenësor). Jeta dhe trashëgimia e shejhut (el-Harawi) qenë shfajësuar nga herezia e monistëve (besimtarëve në *wahdet el-wuxhuud*) dhe unionistëve

fushën e *fana-s* (vetasgjësimit), përsoset me dijen e *beka-s* (qëndrimin), dhe i afrohet thelbit të bashkimit. Kjo ka tri shtylla:

- Të lësh atributet të zotërojnë mbi shenjat treguese të tyre
- Të lësh shkallët (stacionet) të zotërojnë mbi kuptimet e tyre
- Të lësh realitetet të zotërojnë mbi shprehjet e tyre. Kjo është njohja e elitës, që gjendet në regjionet e realiteteve⁹.

Niveli i tretë është një njohje e cila është e përfshirë në mësimet hyjnore (*ta'rif*)¹⁰ dhe kjo nuk arrihet me anë të provave, nuk tregohet me anë të shenjave treguese, dhe nuk realizohet me ndonjë mënyrë. Kjo ka tri shtylla:

- Dëshmimi i afërsisë
- Tejkalimi i dijes¹¹
- Të parët e bashkimit

Kjo është njohja e elitës së elitës.

(*ittihadijeh*). Në bashkimin e dëshirave, personi njih parëndësinë, karakterin kalimtar, dhe varësinë e çdo gjëje tjetër pos Zotit (*es-siwa*), kështu që nuk lejon që këto t'ia largojnë vëmendjen e zemrës nga përqendrimi i plotë në Të. Në këtë bashkim, manifestimet anojnë drejt bashkimit në atributet (*siffat*) dhe atributet bashkohen në qenësinë (*dhaat*). Për shembull, shumë ngjarje përreth nesh janë manifestime të mëshirës, fuqisë, dhe urtësisë së Tij. Ti do të shohësh atributet e Tij në këto dhe më pas do të shohësh të gjitha atributet në një qenësi hyjnore (*dhaat*). Pëlhura e kësaj ekzistence do të jetë një tërësi dhe zemra jote do të jetë në paqe.

⁹ Në këtë shkallë, zemra sheh realitetet, kështu që shenjat treguese gojore dhe universale të realiteteve errësohen nga realitetet, dhe mjetet errësohen nga përfundimet.

¹⁰ Këtë shkallë shejhu ia kushton vetasgjësimit. Ti nuk sheh ndonjë nga veprimet e tua, prandaj asgjë s'ka të bëjë me njohjen e vetvetes, por vetëm me të mësuarit / të shkaktuarit e njohjes (*ta'rif*) nga Allahu.

¹¹ Kjo nuk do të thotë të rrënosh themelet e dijes, por të ndërtohet mbi to.